

SHQIPTAR OSEKU

P O E Z I

Korrektor / Redaktor

Shefki Oseku

Përpunimi kompjuterik

Frashër Oseku

U shtyp me ndihmën e ABF-it në Treleborg - Suedi

U dorëzua në shtyp në muajin prill të vitit 2013

Tirazhi 200 kopje

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG - SUEDI

F A L Ë N D E R O J

ABF-in në Treleborg

Revistën "Drita" në Treleborg

Familjen time të ngushtë

Miqëve që më përkrahën ndër vite: ju jeni familja ime e gjerë

Ballinat: Tahir Emra


Pikturat me motiv të Gjakovës

Vaj në kanvaz, 2002

Për autorin: u lind më 1938 në Gjakovë, master në Akademinë e Arteve në Beograd. Akademik në Akademinë e Shkencës dhe Arteve të Kosovës që nga themelimi.

Më shumë info:

www.albanianarts.com



LIBRI BOTOHET ME RASTIN E 100 VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Libri botohet me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

Orëzana, Perri, Aria.
Nils Holgerssoni fluturoi shkurt, por ai qe djalë.
Ju jeni vajzat e babit.

***Është e çuditshme kjo.
S'e pres dot një festë, a një gëzim
Pa më shkuar mendja tek ata që ranë.
-Pse unë jam e ata jo?
Faji i të mbijetuarit.***

Para Shtëpisë së Lidhjes

E shikoj shtëpinë e madhe në fotografi. Dy kate të mbuluara me tjegulla të moçme, dritaret janë sy që shikojnë brenda vetes, e porta nofull e kyçur fort. Ajo e ka thënë një herë të veten.

Kanë dalur zëra të zemëruar që aty, tek flisnin për vendin. Ishte në rrezik. Gjithandej kishin vërshuar kolona ushtarësh që flisnin gjuhë të huaja, marshonin në takt nën flamuj trazues, daulle trumpeta thirrje zëlarta. Prapa tyre batërdia: kullat digjeshin e tymi i mullarëve ngritej drejt qiellit si duar të të mbyturve. Velanijet e Ulqinit fundosur, e fiset e Hotit e Grudës faruar: pleqtë e gratë e Vranjës në qytet e cullët ta këpusnin shpirtin me vaj; burrat kishin mbetur prapa. Do të ketë qenë si Dita e Gjykimit.

Rrëza e shtëpisë thellë nën dhe.
Ajo pushon në errësirë. Nën të
brazda të holla gërmuar nga krimba
të vyeshëm, gurë qindarka romake
osmane serbe kopsa të uniformave
më së thelli: eshtra. Eshtrat janë
rrëza më e poshtme e shtëpisë.
Përfundi tyre turfullon Kau i Zi
gjithë mëri: është punë kau
t'i mbash mbi supe eshtrat e të rënëve.
Kërkon kokëfortësi durim. Kërkon besim.
Kau i Zi nuk flen, vetëm pushon.
Ai kërkon t'i shpie eshtrat aty për
ku u nisën sa ishin plot jetë, shekuj më parë.
Rënkimet e tij enden në muret e
shtëpisë së vjetër: ka mbetur
e skajuar tek një shesh i qetë
në gjysëm të rrugës. Është verë,
një vajzë ha akullore nën hijen e
strehës, prindërit s'duken gjëkund.
Në dimër athua si do të jetë? Duhet
që këtë fotografi t'ua shpjegoj
edhe vajzave të mia. Që ato ta dinë.

(Qershor 2012)

**mëma e përcolli deri te porta
(plaku e kish marrë ngrykë brenda paj
s'e ndjekë burri çunin deri jashtë)
kurse në dritaren e katit të dytë
ia bënin me dorë motrat:
-Vëlla, ktheu prapë!**

(Zahir Pajazitit, dëshmor 1997)

Heronjtë që na deshën deri në zhbërje

**Ata nuk janë më këtu.
Por qeshjet tyre enden këtej pari.**

**Njerëzit i mendojnë gabim heronjtë. Të sertë, buzëhollë.
Thuase rreptësia të bën hero.
(Ndoshta dhe ishin ashtu, në çastin e fundit:
kur u hasën sy me sy me zgjedhjen.)**

**Por unë dua t'ua kujtoj qeshjen që i shpiu gjer aty.
Gazin e tyre, që i mblidhte familjarët.
Heroizmi s'është veçse dashuri e zënë ngusht.**

**Ja se kush mbledh bij e bija sot.
Dashuria e tyre. Flijimi i tyre.**

**Shikoj bijat e mia tek festojnë, e mendoj.
Athua ç'do të më shtynte mua
ta flijoj veten: fëmijët e mi.**

Përgjegja që më vjen, ma ndal frymën.

**Përulu o kalimtar!
Këtu prehen ata që të deshën gjer në zhbërje.**

**E nëse ndjen nevojë t'i nderosh, mos u ndez qirinj te varri.
Mëso të qeshësh e të festosh: të duash si ata.**

(1 janar, 2013)

Veteranët

**i përmendin kush ra në luftë
i qortojnë në të pakryerën
gjuha e tyre s'është e fjalimeve jubilarë**

**pse ngutej ore gjithmonë të ishte
i pari në front e ta
ngriste kryet kur e dinte që
punon snajperi e pse shkonte ore
ta tërheqë shokun e rënë, kur e dinte
se ç'e pret**

**e tundin kokën ende, kaq vjet më vonë
e s'ia falin shoqes pse u vra
e s'ia falin vetes pse s'u vranë në vend të shokut
(i thinjur para kohe ky faj iracional)**

**ecin në grup drejt klubit në mbrëmjen e tetorit
- diku fishkëllon pipi policor -
e veteranëve u ndërron koha e foljes
"kush u vra në luftë", thonë, "shpëtoi
prej kësaj shëmtie prej kësaj dite"**

**fjalët u vijnë në hove teksa vrapojnë
për të qenë përsëri të parët në vijë
e ngrisin prapë kryet ore kur e dinë që
punon kërbaci e shkojnë prapë ore
ta tërheqin shokun e rënë, ndonëse e dinë
se ç'i pret**

Në varrim të Ali Aliut

**Kur shkuam te varri u ringjallën sërish
shufra e gomës dhe çeliku stainless steel
mbanin erë të gomave të nxehta
teshave të djersitura lotsjellësit
me buqetën e mprehtë të aromës së gjakut
të dehur si qëmoti**

**e folën sërish në gjuhën e vet: sirena
alarme radiolidhjesh
urdhëra të shkurtër zëlartë sharje
thuase për të treguar se ishin gjallë e shëndosh
të fortë si qëmoti**

**e ndjeva edhe vetë furinë e tyre
kur ma mëshuan në krye e në trup me Atdhe
tek ashti që u ça e në gjymtyrë
ku më mbetën blanat e Shtetit
e në kokrrën e syrit kur doli nga vendi
si ishte mësuar qëmoti**

**Ne shkuam te varri për ta varrosur kujtimin e tyre
e ata na u ngjallën ndër duar
funerali i tyre u bë funeral për ne**

**ç'bëmë kështu që na zuri prapë nama e zezë
deri kur do të vazhdojë kështu për mua o nëna ime
si qëmoti**

-Nëno, si ta fshijë daktiloskopinë e udbashëve?

puna e tyre s'ka orar zyrtar

**janë profesionistë që e japin maksimumin
në rrethana çnjerëzore**

**të rënduar nga sensi i përgjegjësisë
të huaj në një tokë të sëmurë
të shkëputur nga ëndërra mallëngjyese
(një qeshje fëmije një zambak në aklën e dritares
mu në mes të një pajtimi)**

**janë besnikë me shprehi të rregullta,
para agimit si gjithmonë, shpesh të mërkurave,
nëpër portë të thyer gjumë të shastisur**

**nxitim thirrje sharje goditje
që të mos i japin chansë objektit t'i mbledhë mendimet
t'i forcojë ledhet**

**ashtu do të ishte më keq edhe për të
kryeneçët veç sa vuajnë më shumë pa nevojë**

profesion është edhe ky si gjithë të tjerët

**kur të shkojnë pas detyrës së kryer
prania e tyre vazhdon ta kafshojë shtëpinë si zagar
dhëmbët tek dorezat që i kanë prekur
kullon nëpër mure mbi sendet përmbysë në dysHEME**

**e djali thotë: nënë
këtë s'po mund ta fshij me ujë
e ajo thotë:
duhet të përpiqemi, bir**

o s'ka shenjë nën të cilën do të fitosh ti

**të shikoj fort mirë tek katrithesh në shpresa të vjetra
ta ndjej pulsën e errët të zemrës
frymëmarrjen
e vrazhdë**

**sytë të bredhin nën kapakët e mbyllur
sh-sh-sh
ky është gjumi i RREMË i bishës**

**e di o e di:
ti di të endësh veç ëndërra të ëmbla vrasjesh**

**ncuk
nuk je zhdukur jo**

**vetëm ke marrë një trajtë të re
të kanë dalur dhëmbë të rinj të mprehtë**

**Skype! dritë
sulju!
çirrja! cepat e errëta**

**ore s'ka shenjë nën të cilën do të fitosh ti.
Kurrën e kurrës!**

(tim vëlla, Frashërit)

**Mbështetur te dritarja
e matë matanën me sy**

**plagë e burgosur nën lëkurë
Tash është sërish vetëm shikues**

**po dikur ishte Luftëtar
diçka të shtrenjtë e linte kur tërhiqej
diçka të shtrenjtë e pushtonte**

**Kredhur te nata përjashta
fluturon nën qiell të errët si shkabë
hija e vëllait tim**

a ka Fjalë që i mbushin foletë e dhembjes

Shkurtesa kosovare

LB LPB LDB

PKJ PKSH

AVNOJ OZN-a UDB-a JNA

IB LKJ § 118 CZ KR!

SPB SANU SPS SUP

LDK UÇK vs. VJ

NATO B-52

OKB R1244

KFOR UNMIK OSBE BE

EULEX

~KS

AL, qnp!

Fugë

Të vdekur, ju thërras.

Zdirgjuni panteoneve hije, lini kolonadat.

**Shikoni: fishekzjarre, banderola, fushqeta
që fëmijët i flakin nëpër këmbët e mëtonjësve.**

Flamuj. Nuk i njihni: e thirren në ju.

Bukuria e tyre plakë gjithçka. Edhe vdekjen tuaj.

Të vdekur, shikoni.

Larminë e ndërtuar padhembshëm mbi humbjen tuaj.

Frena fishkëllues. Autobusë me vonesë

kronike. Thirrjet e shitësve, patriarkë e matrona

tek endin robët e shtëpisë. Tufa të korbave

endin namë të keqe mbi ta. Edhe vdekjen tuaj.

Të vdekur, dëgjoni.

Dikush mundohet të bëjë muzikë me gitarë,

me lahutë, me lugë të drunjta. Të tjerët duartrokasin.

Disa ndreqin shtëpinë tërë ditën me tulla e gjak.

Të tjerë ua prishin natën. Nën gurët e shesheve harresa

rrjedh lehtë, si gjak i të rinjve. Edhe vdekja juaj.

Të vdekur, ndjeni.

Një grua tek e përkëdhel fëmijën. Një fshatar

tek shikon me dorën strehë retë sterrë. Një mjek

tek thotë, Merr frymë thellë. Nxirre frymën.

Herën tjetër do rindërtuar gjithçka nga maja

duke nisur tek retë. Edhe vdekjen tuaj.

Una rob Avropa

(dialog me Sonja Okesonin)

Una rob Avropa

**Avropa mençur zemër mira
ndihmo mua posi aviona tanka raketa bum
shporri fqiu ligë Avropa
una fëmija ktheu shtëpia dha çokollata**

**Avropa zonja sertë
qorton shan una shprehi gabim una sjellje gabim
do gabim gëzo gabim mendo gabim
gabim krejt una**

una rob Avropa

**Avropa nuk do trazim
Avropa nuk do shqetësim
Avropa nuk do pështjellim**

una rob Avropa

**Avropa pre teshat una
Avropa dizajn una kukullë vitrina ajo qep shqep qep
qep flamur shqep kufi qep ligja shqep drejta una buza qesh
una kukullë rrallë
Sui Generis**

una rob Avropa

**Avropa shumë para
Avropa ble shumë sende
Avropa ble una**

**una vë gisht ligja
una burgos vëllai trazoi Avropa
una hotel dhoma me ora motra me Avropa
una gato ushqim restorant Avropa
jam rob Avropa**

**Avropa mendo marrëzira sillu krisur?
una rob Avropa
Avropa ujdj fqu ligja jep una toka?
una rob Avropa**

**Avropa lodhë una kryetrasha una primitiva
Avropa këputë mëso una badihava
thotë nëse una jo mira gjuaj una përjashta**

**una zvarrë te këmba Avropa
una luta una qava
përgjërvoja bërryla gjuaj una vrava
una rob Avropa**

**...pastaj, kur të ketë mbaruar gjithçka e të jenë
numëruar humbjet sërish, e tandin kokën, e
i shkundin grimcat e lotsjellësit e
pikat e shiut nga flokët, e bashkë me to
grimcohet e thërmohet e përtoket ngadalë
liria**

**Në trotuar. Mbi vetura. Në parqe.
Mbi supe. Nëpër flokë. Mbi qepalla të mbyllura.**

L i r i a.

***në cep një vjollcë
kërthi në duart e erës
matanë cepit humnera***

**Zurlat e tupanat si t'ish dasëm në
Opojë, por vetëm në mendjen time.
Ti e pin kafenë qetë përballë.**

**S'ke problem që t'i nguli sytë.
Ke dhunti të jesh vetja edhe në vllug dasmash.
Aq më fort në raste si ky.**

E pra kjo më bën përshtypje.

**Pirja e kafesë është dhembshuri
I ftuar kur je kështu në dasmën e Rexhës.
Kalit brendë i ndihet hingëllima.
Është mëngjes në kuzhinën time.**

krishtlindje 2012 e një kujtim i dëbortë
më resh përreth kokës, më mbështillet
si çallmë e të urtit mevlevi
që e di se vetëm me kuçedrën nuk rrihet në shtëpi.
Sikur kulçedra të kishte ngjyrë, formë, shije, zë,
të gjithë do të merrnin arratinë me panik.
Por fshihet harbutshëm. Në zemër. Në krye.
Të pret durueshëm në shtëpi ashtu siç pritet preja.
Frymon tinëz. Ia dëgjoj zemrën,
hidhërimin që i rrjedh ndër vena shshshshshshshsh
rrahjen egërshane të zemrës: jam këtu: jam këtu: jam këtu:
Stuhi e dëbortë vallëzon nën tingujt e lashtë paganë
i lëkund gracioze kindet e fustanit të bardhë
nën okarinë ere, si mevlevi i urtë që e di
se duhet ta zbusë këtë kuçedrën, ta vë të flejë
se ka rrezik që t'ia ndërtojnë një autostradë përmbi
si mbi varrezat e vjetra në Gjakovë: hiç ndryshe:
e i pëshpëritë, nina nana o pëllumb se ty nana te do shumë
nina nana more pëllumb flej se babi të do shumë.
Unë jam dëborë, heej. Duart e mia të dëborta janë.
E mbërthejnë atë gjakovarin atje larg
që më shikon në sy e qeshë me tërbim.
Stuhia është fryma ime. Era harbimi im.
Kuçedrën që më gërvisht nga brenda e
mëkojnë të gjitha përditë me tambël e mjaltë.
Ajo është shenja që ma ke lënë ti.

Park në tetor

**Prisje të gjithë të bëhen poetë,
Zot të bëhet çdo poet. Doje
gjithçka ta risajosh nga e para.
Ani kush, se. Ty që zemra t'u thye
sa herë - më del gazi -
e në cifla terri kullove gjak.
Tash të poshtëron edhe era ndër pemë.
Ajo nuk njeh poezi. Veç
frynë, e paqëllimtë: rjep sipërfaqe.
Era poezi nuk njeh.
Na, ky është fundi yt. Tetor dymijëediçka,
ditë e ftohtë vetëm në park.
E ti je fshirë nga Libri i Fjalëve.
Athua. Po të të jepej një shans i dytë.
A do të bëje njësoj përsëri.**

Në vendin ku bluhen shqiponjat

**ia nisin mëmat, me qumësht e mjaltë
e shembuj të vegjël të përditshëm që ndjenja
s'çon peshë e uni peshon lehtë e që
duhet të mendosh së pari për këtë e atë para se
të mendosh për veten tënde e ti
e merr vesh ngadalë si duhet ta matësh veten
qumësht e mjalti i mamasë
e etërve u ndihen krismat veç tek pikat kufitare,
s'rastisin kurrë kur ti pëshpëritë për dashurinë
për menstruacionin për virgjërinë për seksin
janë të zënë duke ndërtuar shembullin si duhet
t'i mungojë babai dashnori burri femrës
e merr vesh mes negacionesh se ku e ke vendin
xhani e pëllumbi i babait
pastaj vijnë gjithë të tjerët, mësuesit që mendojnë
se u teprua me këto pallavrat moderne e se djemtë
duhet të jenë djemë e vajzat vajza, e drejtorët
e profesorët e dashnorët e politikanët
që i kuptojnë njerëzit e thjeshtë tek i tundin
gjithë dyshim kokat e urta e pyesin athua pse
hajt pse u dashka që robi ta prish dorën e Zotit
"Mendo mendime të sulmueshme, o rri e vetmuar"
thonte Jane Hirschfield, por ajo kish hesap
të jetë e lëndueshme - ti s'ke bija ime
po e lëshove gardin do të ta ngulin fajin
e ndjenjën se je defekt gjer në palcë të ashtit
e s'do ta provosh kurrë dallimin mes mbijetimit e
Jetës: fatin që po ta shkruajnë: ndërroje!**

**ishim shokë, ashtu thonim
kishim qenë me vite**

**e ka kokën e trashë
edhe figurativisht, sy
inteligjentë që zhbirojnë kaltërisht
e buza i qeshë shpesh
me veten**

(rallë, edhe me të tjerët)

ishte shok i mirë

**nuk shiheshim shpesh
por kur ndodhte, e bënim përherë
atë saldimin e pllakave të kohës që
e bëjnë shokët**

**mund të flisnim me orë për
shëfën në punë, ditët
e këqia të gruas, e të fëmijëve**

**(e ke shok veç kur të lë zemra
edhe t'i shash fëmijët tu me të)**

**hamburger, pommes frites
coca-cola në McDonalds**

**ndonjëherë i zgjidhnim edhe
çështjet e mëdha-a-aja
kombin a fenë a gabimin e radhës
të kryeminsitrit**

fajtori e bënim Ndarjen

**(gjithmonë atë të madhen të kombit shqiptar
kurrë jo këto të voglat të dy shqiptarëve në McDonalds)**

**kishte ditë kur na e mëshonte pa paralajmërim
nostalgjia, e mbështeteshim te njëri-tjetri
në larteposhtat e kujtesës**

**fqiu i mirë që e fshihte traktin
mësuesi spiun që e kallëzonte në sigurim**

dashuria e parë

**sëmbimet absolutisht të pashpjegueshme në zemër
që shpjegohen krejt lehtë po deshe, por kurrë nuk do**

**shokët e mërgimit i kanë këto
mirëmbajnë serra të kujtesës e kultivojnë
bimë të harruara nga evolucioni**

**kur vinte fjala te poezia ishte vigjilent
-E pashë që e kishe shkruar një vjershë...
-Po, ore. Kush ka nge, shtin rruza n'pe.**

**I shmangesha në maje të gishtave
kësaj teme të ndijshme
e bisha i zbutej gradualisht, gjersa
shlirohej përsëri**

**e nuk e di se ç'ka ndodhi me të
ndoshta realiteti marshoi më në fund në botën e tij
ia prishi serrat, bimët e harruara ia shkuli
e dheun e tyre ia shpërndau me çizme**

Itaka

**ndojherë më pëlqen të lundroj
është liri e çuditshme**

**velahapur spirancëmbledhur
valë e paemër**

**e më sëmbon në det të hapur
diçka e motshme**

**shiu ndoshta, a vesa
në kopshtin e pleqve**

**e tingujt e lashtë
jare përmetare gjakovare**

**e dua ta kthej anijen sërish
e s'më kujtohet më**

**për ku qeshë nisur
e ku do të shkoja o njeri**

**e deti që më ka dashur gjithmonë
më tremb me boshllëk**

**Na këputi ky tetor.
Vera ende kujtim i gjallë
sëmbon tinëzisht**

**dëbora do të ishte shpëtim
po tetori katil: ngreh e mos këput**

**Andaj, presim durueshëm.
Guximin e tharmojomë.
Me pika të rralla tingujsh
e mbajmë shpirtin.**

**S'bën fare tetori
për njerëz të brishtë.**

**Po dal të pij kafe me dikë
thotë, e i merr
çelësat e veturës nga tryeza
ndërsa unë shkruaj për revolucione
kur mbyllet dera
e lë lapsin të rrëzohet
Bastille po bie
Allons enfants de la Patrie
regjimi mijëvjeçar po thyhet copash
në të gjitha frontet
po ngadhënjëjnë armatat e boshllëkut
tokë e djegur dy njerëz të përvëlur
fëmijë që rriten nën gërmadha
pushteti i ri nuk të fal
i shpie robërit te gijotina në shesh
e i kundron duke pirë kafe tek vdesin**

**e shikoj kohën në titërr të syrit
e shthurrem butësisht
shkapërderdhem
nëpër natë lundroj me velat lartë
faji anija ime deti im dashuria
historia e të kuqes valon flamur në traun e mesit
Allons enfants de la Patrie
s'ka më madhështore se kur lundron drejt fundit**

**Duhet duhet duhet
të marr
frymë
të marr
frymë**

**kalon edhe kjo
bëhet mirë
dielli lind
krejt harrohen**

**Qenie e lirë, e zënë në kurth:
dridhem kur e shqisoj të panjohurën.
E mbaj frymën. Kërkoj të fshehem në errësi.
Ç'pusi më ndjek kështu me pishtarë nga pas?**

**Ti do të mund të më vrisje duke qeshur
e unë do të vdisja veç nga frika prej afrisë**

**jam i duruar pa kufi
e nuk dorëzohem kurrë
e ndjej dashuri e dhembshuri
e jam fëmijë me konsideratë
e prind shembullor
e bota megjithatë më thyhet
copash**

prapë e prapë e prapë e prapë

**ajo që ndjej për ty
atë që e përjetoj kur mendoj në ty
përshtypja ime për ty
mbresa ime rreth teje
mendimi im për ty
imazhi që kam për ty
figura që ma ke sajuar
për veten tënde për mua për ty**

suma sumarum

**po ta përmbledh këtë që e ndjej
ta them të drejtën
ta them kah del shpirti**

**sa shumë togfjalësh që sinjalojnë turbullt
sa shumë tërheqje ngurrim
konsideratë**

një fjalë gjashtëgermëshe, e gjithë ajo frikë

**e kanë një cilësi të veçantë, gratë egoiste
që u përputhet me natyrën e mashkullit.**

**egoizmi u del dorëzan
kur është me ty, e di se përse
s'do ta kesh as hijen e dyshimit
ajo të dashuron, pikë**

**them se egoizmi qortohet shpesh pa faj:
vdektarët duan ta shporrin
padrejtësinë mizorinë lëndimin
e ego veç rasis që shkruhet më lehtë
të lutem e dashur, bëhu egoiste**

**E mbaj mend dashurinë e parë:
i pëlqente të luajë me zjarrin.
Kur digjej, qeshte. Për inat
të hasmit. S'kishe si të mos e duash.
Gjithë shokët ishim dashuruar në të
Ajo, veç në lojërat e veta. Në to!
Ishte studiuese e devotshme e dhembjes.
Bebëzat, metal blu i akullt
i zmadhoheshin, mbaj mend, kur
këpuste flatra insektesh, e
frymëmarrja i shpejtohej. S'kam ndjerë
kurrë diçka më... joshëse, ndoshta?
S'e di. Do të ketë patur fëmijëri
të ligë. Kishte aty shumë rrëfime
të pathëna. Por një gjë e mbaj mend:
i pëlqente të luante me zjarr
e kur digjej, qeshte për inat të hasmit.
Them se qeshja i qe konstanta e panjohur.**

(shoqes sime)

Dy dashnorë në muzikë. Sonata
nr 23 opus 57 pulson përreth tyre.

Ç'të them, është jeta jote.

Ti vendos se cila do t'u prijë hapave tua në jetë.

Frika apo shpresa.

Por këtë po ta them:

këtë ta bën dashuria

të shtyn t'ia kumtosh tërë botës

E Betoveni përreth jush kumton, që

s'ka njerëz me zemërgjërë se të dashuruarit

ia urojnë atë që e ndejnë vetë të gjithëve

duan t'i bindin dyshuesit

t'i mëkojnë të gjitha plagët

Andaj kur të ngritesh nadje e të tundojnë djajtë

shporri me këte nuskë:

"Gjithçka që Ndodh

Ndodh prej Dashurisë!"

kështu shoqja ime: ia ke borxh vetes ta ndjekësh zemrën

Nëse shkon keq, do ta kesh gabimin më të denjë në jetë

por nëse, them: nëse të shkon mirë...

...oh nëse të shkon mirë!

sa detëra lumturie do të lundrosh

e imagjinon dot?

**Sot dola në plazh sërish.
Qenka braktisur frikshëm. Moli tundet rënkueshëm.
Gjethe hala të blerta, që ende frymojnë jetë,
ca bishta cigaresh të hutuar
para ndërsyrjes së valëve. Përfundi tyre
rëra, ka nisur t'i hajë me nge.**

**E pra, në fundjavë gjithçka qe ndryshe. Çunat
bërtisnin emra gocash tek kërcenin në ujë,
prindërit lyenin gjymtyrë fëmijësh me krem dielli.
Gjethet luanin me erë, e vogëlushet e mia
u ngazëllyen kur i gjetën dy guaska mu nën mol.
Këmbë të pandrojtura endnin piktura hareje në rërë.
Rëra nuk bëhej e gjallë.**

**Herën tjetër, do t'i marr prapë
bijat e mia. Ato, magjistare të mira,
dinë ta ndalin rërën të mos hajë gjithçka.**

**Kam qenë re e mjegulltë, erëbartur.
Sajesë e grimcave të ujit që e endin
pëlhurën e jetës me rastësi.
Drugëz ëndërrimtare për vekun tim.**

Por tashti më ka rënë këmbana.

**Jam ngarkuar. Më sheh?
E kam mbledhur tërë shkathtësinë,
vullnetin, e gatishmërinë, që mund të mblidhet:
tani jam gati për të shkrepur.**

**Në këtë moment, historia ime bëhet histori.
Në këtë moment, një fillim i ri bëhet i mundur.
Në këtë moment
jam rrufeja që lyp të ndahet prej errësirës.**

Atë që po pres, është shkëndija jote o njeri.

**E di edhe vetë: shkëputja shkakton dhembje.
Dhembja ngjall frikë. E frika dyshim.
Hallka të vjetra na mbajnë të mbërthyer.
Zgjohem shpesh i thyer syresh, e,
i shkatërruar, veten e ndërtoj sërish.
Në pritje. Në pritje.
S'e djeg dot ajrin pa ty.**

**Vështirë ta besosh
kur shikon dyndjet përreth: por
në sy të stuhisë mbretëron prehje.
Pritja e ka një kuptim.
Thellë në vete e kam të qartë
se kjo është beteja ime e fundit për ty.
Dua ta bëj madhështore.**

**Do të ketë ndryshuar gjithçka: shtëpitë
do të jenë zvogëluar rrugët ngushtuar
te brigjet e Krenës selvitë rrudhur nga pleqëria**

**Ti end fjalë që druaj t'i kujtoj
e zëri yt më hapet në zemër
jetët tona s'po prekin në tokë qëkur**

**Ura nën ty do të jetë sa një fije shkrepëse
lumi përfundi një përrockë e fishkur
ta kapërcesh me një hop**

**gruaja kredhur në gjumë:
gjymtyrët s'zënë vend, flegrat
e hundës hapen me ofshe, sytë
lëvrijnë plot panik
nën kapakët e mbyllur**

**mbase ka makth:
fëmija në bark i thotë lamtumirë,
ose grindet me të ëmën, deri sa
i vie të qajë, ose i bëhet se ka mbetur
vetëm**

**pastaj qetësohet:
ndoshta mbaron ëndërra
apo i kthen mbarë**

**e sapolindura thithën ajër
nuhat botën**

**dëgjon tinguj të panjohur
e kureshtjen e shetit ndër to**

e përkëdhel me sy

**unë jam atjehja
atjehja jam unë**

e qan

**dhembje e kureshtje
foshnja ime**

**hije herake murmurojnë
këmbëkryq te kryet e djepit**

**do ta zëmë rob
do ta kurthojmë me lavdata e qortime
me keqardhje të shtirur me premtime të qeshura
me këngë sirenash
do ta lidhim me vargonj ëndërrash e shpresash**

**fati yt po zë fill me fije të holla
gëzimi im**

**qofsh me fat foshnja ime:
një ninullë t'i trazoftë hijet përditë**

Në ditën e mbramë të shkollës

**E shikoj vogëlushen time, të mbledhur në rresht
siç di veç fëmija në oborr të shkollës
është veç një gjysëm dite larg nga liria, kur s'ka
detyra korigjime drejtshkrim**

**është mahnitëse sa saktë e duron pritjen
athua ku e gjeti gjithë këtë disiplinë**

**athua do të trembet në çastin e fundit, kur t'i lë pas shpinës
muret flladitëse të klasës ledhet e mësueses
e ta tokë dorën me botën e valë plot prekje tinguj aroma
nuk bën ta lë vetëm**

**gënjeshtat e babait janë qetësuese siguruese si lojë në
përrallë
thonë se ka rregulla që mund të mbrojnë mirësi që
shpaguhen
shkathtësi që e ndajnë dritën prej territ yshtjen e mirë prej
të ligës**

**nëna e vet i vë gënjeshtra të vogla si nuska për mësysh
nën sqetull nën nënkresë në aklën e dritares
janë mjeshtri të nxëna brez pas brezi, nga nëna në bijë**

**kur gënjen gjyshja vogëlushja është e bukura e dheut
e ka zërin e perrive flokët e Tanushës
princeshë e rrethuar me njerëz që e duan përgjithmonë**

**xhaxhi i kthyer nga lufta e gënjen për rritë të rehatshme
në shtëpi rreshtore me trampolina në kopsht
aty nuk lihet shoku në pusi nuk mbetet amaneti peng**

**veç mëso të thuash në kohë e me vend Falemnderit
S'ka përse Më fal Të lutem e gjithçka do të bëhet mirë**

**vogëlushja ime mes shoqeve në oborr të shkollës
e mbërthyer në rresht një gjysëmdite larg nga liria
do t'i duhet të tjerrë dritë prej një errësire të lashtë**

Nëna ime shpëton princesha

**Nëna ime luan me bijat e mia të vogla
i pëlqen të jetë gjyshe**

**në dysheme, dinozaurët e kanë rrethuar një princeshë
ajo ndodhet para një rreziku të madh
mund ta hanë të gjallë ta shtypin ta fërfëllojnë me bisht
ta djegin flakë**

**nëna ua vesh çorapet mbesave mjeshtërisht
pa e prishur dramatikën e situatës**

**kjo ishte gruaja që ma vinte dorën mbi ballë
kur më digjej flakë
athua iu ka ulur athua do të hajë athua do të flejë**

**është mësuar ta shprehë dashurinë duke u brengosur
në vend se Të dua: Mos po ftohesh bir Mos po sëmuresh**

**Në të mbëdhjetat: Mos po vritesh bir Mos po të kapin
Edhe tash: Mbetë keq bir Mos të pikëllohen fëmijët**

**po s'u brengos një ditë e mundon ndjenja e fajit
e shan veten se nuk di të dojë**

**nëna ime me shkollë fillore
ngurron t'i mbushë formularët dëftesat shkresurinat**

**nëna ime me gjunj të sëmurë
dy këmbë mbi çdo shkallë dy duart te muri**

**nëna ime me dorë të rrëzbitur
dy duar për një paketë qumësht dy sy tek paketa
nëna ime me shpinën që i dhemb
dy sy të mbyllur në dhembje dy nofulla në ngërç**

nëna ime me këmbët e enjtura
nëna ime me flokët e rralluar
nëna ime me çarçafët në valixhe
nëna ime me kujtimet e veta
nëna ime me harresën e vet
nëna ime me çantën e vjetër të dorës
-s'e ndërron se ia bleu djali

nëna ime me kostumet e prera
vajzë motër grua nënë punëtore e tekstilit mërgimtare
ardhacake gjyshe

nëna ime zero në patriarkat
s'iu dha rasti kurrë të jetë Njeri

nëna ime tashti plakë

dinozaurët e hëngrën së gjalli e shtypën
e fërfëlluan në bisht

e djegën flakë
ajo do të duhej të ishte e mbrama sa për shpëtim
të princeshave

por ja që ajo s'kujtohet fare për atë punë
por ja që e bën prapë, siç e ka bërë gjithmonë

e nxjerr viktimën nga rrethimi e përkëdhel i jep të
hajë të pijë

Mos u trembe bijo Mos të vranë gjë ata dilidreqët

e vajzat e mia të vogla e duartrokasin zëlarta:
Urra, gjyshja!

**Në babëgjyshin tim banonin enigmat.
Ai e kishte një kosh të thurrur me fije kallami
Zymbyl e quante
të cilin, nga ç'e kish lejuar veten ta tregonte,
ia kish dhuruar një mik i mistershëm
për të cilin s'fliste kurrë**

**Ai e ndjente dashurinë e çuditshme të zdruckthtarit
për drurin e qiparisit
mbolli shumë prej tyre
sharroi e gozhdoi ca më shumë**

**ia puthte pragun punëtorisë
në të hyrë (saktë në ora 05:00) e në të dalur (saktë 20:00)
çdo të lumen ditë pa dallim pa mbarim
zejtarët e Çarshisë së Madhe i kurdisnin orët e xhepit sipas
orarit të tij**

**"nuk është zdruckhtari kjo o Shqiptar po arë e mulli:
kur vjen shteti ta merr miellin në shtëpi
ky prag të nxjerr miell të ri", më tha një herë kur isha i ri**

**jetoj në koekzistencë paqësore me gruan e vet
vajtojçën e celebruar e asaj ane
që ofronte vajtime të përmendura
kundrejt një porosie të tabutit a arkivolit tek i shoqi
(kurora e luleve plastike kushtonte ekstra)**

**fëmijët e vet nuk arriti t'i shihte aq shpesh
se i donte fort**

**dashurinë ua shprehte me "plotësim të kushteve":
tajma të nxehtë të bukës e mish në sofër sipas mundësisë
me adhurimin e analfabetit për shkollën ua hapte kuletën
e ata mirnin aq sa u kushtonin
librat e matematikës fizikës raketës satelitit
elektrokardiografisë
shumat e llogaritura që më parë u tepronin**

për të parë Omar Sharifin e Xhuliano Xhemën
në kinemanë e re
e ku ta dinte plaku që raketa
sateliti elektrokardiografia nuk ishin lëndë mësimore
(disa prej fëmijëve më vonë u revoltuan kundër dërrasave
sharrave e puthjeve të pragut
në një revolucion të mbarsur gjithë keqkuptime)

emri i tij ishte Sakib – ”zotëri” në urdu
një gjuhë që ai as që e dinte se ekziston

i tillë që gjyshi im
bënte gjëra që s'i dinte, e dinte gjëra që s'i bënte

si ia kishin lënë këtë emër që e panjohur
për të e për të tjerët
por e mbante me dinjitet
mund të themi që i bënte nder emrit, si zotni i vërtetë

mbiemri, ”vërshim” në sllavishten e vjetër
poetike mund të duket
por as atë gjyshi i gjyshit s’e kish patur fat ta zgjedhte
që popi i ri i katundit që e pagëzoi
tok me të tjerë që rastisën aty kur ua mbyti pronat Drini

(të ta ndërrojnë emrin është punë e lehtë
por ia sheh njeriu sherrin:
bëhesh farefis me farefis që s’është)

thuhet që gjyshi kish qenë bonjak si i ri
para se të dilnin ligje e prroçka tjera të atij lloji
para se ta mashtronin fëmijët me libra të raketës
encelografisë

Trim, e quanin shokët pleq – Burrë i Dheut

por mua më kish thënë në besim
se e kish varur pushkën në gozhdë të ndryshkur
se kish lindur që në krye për të qenë burrë baba
zdrukthtar

**i shmangej politikës, që zejtarët e diskutonin përditë
pranë mangallit
thuase s'ishin shalëpunues, litarpunues, kallajisës,
zdrukthtarë analfabetë në Çarshinë e Madhe**

**por si t'i kishin thirrur enkas për t'u ndihmuar në Jaltë
Ruzveltit, Stalinit e Çurçillit
"politika është kurvë" ishte komenti i vetëm i plakut, që
e përsëriste si bismilah a si atynë që je në qiell**

**i tillë qe gjyshi im
bonjak analfabet i bërë bashkëshort i bërë baba i bërë
sufist i bërë ndërmarrës i vogël
rrugë goxha e gjatë për një njeri të thjeshtë, po ta mendosh
e kishte një bastun të lëmuar nga mahagon i errët – Kërruta
të lakuar në krye
si një shtagë hokeji por jo tamam, krenaria e shtëpisë
e trokiste kalldrëmin me të, si për t'ia shkundur pluhurin
ëndërrave**

**është gjithmonë vështirë ta përshkruash një njeri aq të
veçantë**

**Gjyshja i ruajti Zymbylin e Kërrutën shumë vjet pasi ai
shkoi
një shprehje e vonuar dashurie, mund ta supozojmë**

**Kah fundi i vet ajo nisi të kuvendonte me të sërish
t'i thonte që s'i kish hije një sufisti të tallej ashtu në moshë
të shtyrë**

**Kur isha i vogël, nuk sëmuresha kurrë
ndonëse kisha pneumoni verdhëz epilepsi
ordinanca ishte vendi ku lozja me stetoskopin
tejzat e elektrokardiografit pajisje astronautësh
avanturë hesapi, herë gazmore, herë frikësuese**

**Fëmija s'ka fjalë për sëmundjen.
Zjarmia s'është status mjekësor
po shikim që djegë në sy.
Plogështia, dëshira për të luajtur
kur s'të lejojnë të rriturit.
Të vjellat, hundë që djegë.
Pa oreks: ushqimi favorit i gatuar keq.**

**Unë nuk qaja pse lëngoja, po pse ime ëmë
bënte gjithçka gjithçka gabim
e im atë do të kish bërë gjithçka gjithçka perfekt
po s'rastiste kurrë në shtëpi**

**ky ters i përsëritur më bënte të xhindosem
ndërsa ime ëmë m'i ndërronte çorapet me uthull**

**spitali ishte vendi ku më çonin prindërit
për të pushuar nga loja e dhembshme e grindjeve
me mua larg ata sigurisht s'kishin pse të shtiren
sigurisht uleshin dorë për dorë në ballkon
e flisnin me zë të ulët, e thonin fjalë dashurie**

**në fund të çdo qëndrimi prisja përherë të më thonin:
"Eja në shtëpi, se s'do të shtiremi më"
(e ata e linin gjithnjë për herën tjetër)**

**qeji suprem, kur shkoja te xha doktori në Shkup
atje shkoja me tim atë, ishim vetëm ne dy!
pa çka se më linte vetëm në dhomën e hotelit
luaja gjithë gëzim me një veturë policie
se tërë rrugën uleshim pranë, vetëm unë e im atë
kjo peshon rëndë për një çun**

**dhe kur kthesha dilja në oborr
mbaj mend: nuhatja luledylli e qeshja
me të verdhën mbi hundë.
Sikur e nesërmja të mos kish qenë tashmë.**

**Shkuan, tri gocat e mia.
Një javë te i jati, e
një tek e ëma: cikli shtegtar
i divorcit. E ato,
mjellma të reja,
fluturojnë të pamësuara ndër re.**

**I shikoj tek ikin, e ndjej
se po i ngjaj gjyshes së ndjerë.
E ngatërroj dashurinë me brengën:
I dua, duke ua patur hallin.**

**Zemra më thotë që do të bëhen si unë.
Andaj po mundohem fort fort
që të bëhem unë ashtu si ma do zemra
të bëhen ato.**

Vaftë mbarë!

**Gocat e mia janë fëmijë të divorcit
e lypin babain kur janë me mamanë**

e anasjelltas

**ato banojnë në dy ishuj të mungesës
navigojnë në ujërat e turbullta mes tyre**

**lundrojnë mes tyre çdo javë
në veturë të ngarkuar me lodrat favorite**

**kështu punon ndarja
sajon Uliksë prej malësorëve**

**them, mbase bëhen lundëtarë të mirë
mësojnë ta çmojnë erën e mbarë**

**në rastin më të mirë bëhen magjistarë:
mësojnë të shndërrohen në dritëhedhës skaj detit**

**si t'i shtrojnë fërfëllizat
si të krijojnë erë të mbarë me fjalë e me duar**

**ca pyetje më mirë të mos thuhën
ca përgjegje, të ikin pa u dëgjuar**

**si t'i them një dyvjeçareje të sëmurë që
mamaja nuk do të vijë**

**qysh t'ia filloj realitetet e jetës
punën faturat rrogën strehën mbi kokë
dashurinë e thyer
ndarjen**

**Aria e vogël qan tinguj të hollë
si këlysh i rrahur**

jashtë shkërryhet maji në ngjyra të sëmura

**e ku ta di unë ç'është kriza
e identitetit?!**

**Identiteti im e ka të
vështirë të pësojë
kriza, në kuptimin
përmbytje, katharsis, ringjizje
në yjësi krejt të reja.
Revolucionet janë të lodhshme
dhe (kur t'i kesh bërë
nja dy a tri) edhe
të mërzitshme**

**identiteti im është, s'di
si ta them... si
guri i mullirit, ndoshta?
që bluan ngadalë e
pareshtur, i thërmon
kokrrat e përvojave të
reja në një miell të
imtë, që resh pastaj
përfundi si pluhur mbi
miellin e vjetër në thasë
të arnuara.**

**Në fund fare vie
unë, mullisi. E
i përziej thasët me
dorë të mbarë, apo -
po qesh çuar në krah
të keq -
me dorë të mbrapshtë.**

**Thasët e mia
s'e honepsin fjalën Krizë.
Ato veç vuajnë
nga përzierje të mbrapshta.
Arnat që grisen nganjëherë
e sitin të kaluarën.**

Kësaj i thonë poezi!

**kur ti qeshë me sy e
duartroket nga gëzimi i
papërmbajtur se ja
u bë, ja arrita në port,
e kur kënga e haresë tënde
leviton mbi orenditë, mbi
mua e ty, si hyjni e
harlisur mbi anijen që
dredhon mes kepave të
mprehtë nën blunë e atij
çasti lozonjar**

ajo është poezi, e jo në libra

**Është në zeje të veten, shiko:
tehun në dorë, qengjin në pëqi
ia mehë frikën me ledhatim mes veshëve
i flet me zë të ëmbël për pranverën
për barin që kulloti pak më parë**

**dashuria e detyron
ta ketë dorën e lehtë**

**Kam ndryshuar
në mënyra që s'thuhën dot.
Kam vendosur
ta mbaj vetëm barrën time.**

**Ti mbaje e lirë tënden.
Dhurata ime për ty është që
unë s'të ngarkoj më.
Liria është dhurata ime.
I kam parë
ato që nuk i shihja dikur.
E kam derdhur
veten time në ty e anasjelltas.
Ruaje veten.
Risja ime për ty është që
unë do të shoh.
Prania është dhurata ime.**

**Kam mësuar
ta zvogëloj të keqen e madhe, e
ta hedh në Erenik
atë të voglën, të përditshmen.
Na i marrtë të ligat.
Dhurata ime për veten është
se të kërkoj ndjesë.
Është dashur të të kërkoja qëkur.**

**Amnesty thotë: Çdo e treta shqiptare rrihet!
U thyhen eshtrat gjymtyrët brinjët
blanat ua mbulojnë trupin
u firohet pareshtur trupi që mbanë jetë
(shpesh herë mu pse mban jetë)**

**armët që përdoren në këtë luftë
duart këmbët lindur rritur ledhatuar nga viktimat
të lara të mbështjella të vajosura prej tyre
si gjymtyrët e një Krishti mizor**

**shufra shkopinj purteka
vegla që gjinden lehtë në habitatin natyror të Bishës**

**pajisjet e vyeshme shtëpiake
ujtitë gotat botilet e mbushura dhe boshe
rrypat me kokalla të madhësive të ndryshme
thikat e kuzhinës
kjo luftë është agresion i paligjshëm**

**pa mbështetje në rezolutat e Këshillit të Sigurimit
pa konferenca të paqes pa ndërhyrje ndërkombëtare
pa asnjë shpresë të shpëtimit
në të s'ka dorëzanë s'ka ndore s'ka marrëveshje amnesti**

**aty s'jipet falje as kërkohet ndjesë
aty s'ka Gjykatë të Hagës
kjo luftë është efektive**

**low tech high impact si njëqind 11 Shtatorë të heshtur
godet përherë caqe të buta
është e graduar saktë**

**ka përherë alibi morale
- ja ku i keni librat e shenjtë po s'besuat
kryhet kujdesshëm
në Guantanamo shtëpiake
për ta mbrojtur agresorin prej padive eventuale**

**kjo luftë është totale
nuk njih klasë nuk bën diskriminim fetar
në këtë luftë të ndotur
hetuesi është i njohur i viktimës
babai vëllai dashnori burri
që e ka ndarë bukën e kripën e jetën me të**

**që ia njih sekretet, ëndërrat e shpresat
prandaj mund t'ia thejë aq saktë
-mos u habit, edhe këtu luftohet për zemrat e mendjet**

**ai i thotë se e do, shpesh beson se e do
do t'i dilte e vërtetë në test të poligrafit**

**traumat e kësaj lufte janë afatgjate
mu pse dhembjen ta shkakton i joti
të vret dora që dikur t'i përkëdhelte flokët
-ndoshta t'i përkëdhelë prapë mëpastaj**

**ai që e ka ndarë ëndërrën tënde di si ta shkatërrojë
ai që ta ha bukën ta përmbys kupën**

**e kam parë unë e ke parë ti
s'ka njeri të mos ketë parë
por unë zgjedh të hesht
e të them si qytetari nazist Nuk e kam ditur
-heshtja ime është roje e kampit**

**pas një përvoje të tillë
s'ia vlen më të ëndërrosh të shpresosh
s'ia vlen të rrosh
jeta pas saj nuk jetohet po durohet
vdekja të bëhet çlirim**

**Amnesty thotë: Çdo e treta shqiptare rrihet!
Po kryeministri e feston hyrjen në NATO
e Shqipëria firmos marrëveshje me Bashkimin Evropian**

**prandaj s'ka pse të frikësohet askush
as nga tribunali i Hagës as nga Brukseli:
lufta mund të vazhdojë lirshëm
lufta mund t'i edukojë rehat rekrutët e rinj
t'ua përkëdhel flokët
e unë mund të...**

Dashurrejtje

**Kur të vijnë për të të pyetur Pse
dije se të erdhi fundi**

**do të rripesh ngadalë
prej gishtit tregues
që t'i shenjon fajet**

**Se, kaq di edhe fëmija:
aty ku ka gisht tregues,
do të ketë patjetër faj**

**Dasëm pa mish s'ka as tym pa zjarr
E njerëzia duan të festojnë**

**Ta skicojmë një njeri. Flokët, sytë,
shtati - e shikon? Le ta ketë
një jetë. Përvoja të mishëruara.
Disa më dramatike se tjerat.
Ato ia përzgjedhin fjalët.
Ti s'ia lexon dot mendjen
as shpirtin tjetërkujt:
ia dëgjon vetëm fjalët:
ia shikon vetëm sjelljet.
Ky është predikamenti yt.
Ky është kufizimi i vetëm i kësaj loje.**

**Ta bëjmë interesante: t'ia shtojmë
një histori. Flokë, sy, shtate tjera,
i shikon? me miliona të palosur
në radhë të krehura, nën këmbë, rreshta
në tokën e errët. Ata janë
historia. Shpresa e frika, besime
në zotëra të harruar. Ti
s'ia lexon dot mendjen: as shpirtin:
por mund ta dëgjosh sa e flet
gjuhën e të fjeturve. Kjo është
ahmarrja e tyre mbi të gjallin.
Ky është pushteti i tyre mbi ty.**

**Ta shtojmë tensionin: t'ia shtojmë
një fëmijë. Apo dy. Flokë, sy,
shtate tjera - i shikon? Shikoji mirë!
Tek i bëjnë çapet e para
duke u mbajtur te prindi. Dëgjo mirë!
Tek e flasin fjalën e parë. Ndjej ato!
Hijet e të fjeturve janë kërrusur mbi ta.
I shikon?**

**Ja e bëre një njeri. Nje grua. Një burrë.
E flet gjuhën e të fjeturve. Jeton në të.
Ky është pushteti i tyre mbi të.
Fëmijët fëmijët janë thirrja e lirisë.**

**Me ta - kur është vetë fëmijë - ëndërron
se është dikush tjetër. I tremb hijet
që u aviten. Fëmijët s'flasin ende vetë:
por ç'do të thonë kur të rriten? Andaj
e bart vetë edhe kryqin e tyre,
për çdo rast. I josh të fjeturit të flasin
me të, ta përbijnë atë, jo fëmijët.**

**Në mëngjes, ndoshta e hap dritaren
për ta lëshuar diellin në këtë shtëpi.**

**Ti vërtet s'mund t'ia lexosh mendjen,
as shpirtin tjetërkujt: ja ku e ke të larë
esencën e lirisë**

**Jam. Prej mishi e gjaku e bindjesh të mësuara
Qeshë nga dhembja sikur gjithë të tjerët
i ndërroj situatat me atë lehtësi të shtirur
me të cilën e kam sajuar botën
si Terra Nullum: para Meje asgjë
pas Meje hiç**

**Na mësojnë qysh fëmijë që t'i shkundim plagët
e t'i përmbajmë ndjenjat për të vazhduar lojën
çuni i mirë nuk qan**

**Çuni i mirë nuk shket kurrë në teprime
çuni i mirë i qëron ndjenjat e panevojshme
i ruan vetëm dy ndjenjat fizike: urinë etjen
(dhembjen e përbuzë si të padenjë)**

**mundësisht edhe zemërimin mund ta ndjejë
- ai është yang, mashkullor -
nëse është vrapar, i përmbajtur, i ftohtë
nëse është i rregulluar me kanun**

**çuni i mirë u ruhet ndjenjave të nxehta
çuni i mirë e ruan barspeshën**

**Çuni i mirë nuk varet pas kindeve të mamasë
(por mund ta dëgjojë: nëse është burrneshë)**

çuni i mirë i ngjan babait të vet

**atij i mjaftojnë virtytet për të qenë i lumtur
virtyti kryesor quhet Përmbajtje**

**ai është shkëmb i fortë në një botë përherë në shthurje
ai është etik logjik i arsyeshëm**

**çuni i mirë i ndjek Senekën e Epiktetin pa i lexuar kurrë
e di Shkakun andaj s'vuan kur e ngre qerrja si qenin
filozofia e tij nuk mësohet ajo jetohet**

**ai ka nderë e fytyrë, s'lejon ta zënë me presh për dore
e kur të rritet mbretëron si Mark Aureli
mbi robërit e shtëpisë. Pikë.**

**Kështu Jam. I ndërtuar prej mishi e gjaku
e bindjesh të mësuara.**

Qesh nga dhembja kur shikoj që më vërsulesh.

**Dikush ka për të m'i paguar shtrenjtë
Gjitha turpet e fajet e mia.
Dhembjen. Ndrydhjen.
Jetën time dikush do të ma paguajë!**

**Shkatërrimi e flet gjuhën time yllo
banon në duart e mia këndon n'ereksionin tim**

**E vërteta është se rrethuesit kanë të drejtë yllo
Trojën do rrënuar e shkuar me parmendë**

**pastaj do hedhur një ton kripë mbi rrënojat e nxira
që të mos u mbijë më kurrë barë përsipër**

**ndryshe dashuria e urrejtja
do ta ngritin këtu prapë në folenë e përbashkët**

**Dëbora po jep shpirt matanë dritares.
Zërin tënd s'e njuh më kush këtu. As timin.**

**E di se ç'thonë për kohën e plagët
rrejnë ylllo rrejnë asgjë s'më ndihu të të harroj**

**ti çon një jetë të vëmendshme
syçelë
gjithë mëdyshje
gjithmonë gati për zbrapsje**

unë dua veç t'i preh sytë e ta di që do të më jesh pranë

**ndërsa ti më vështron me kokën anuar
ç'është ky njeri kështu
athua ç'do prej meje, në të vërtetë**

**si t'i kuptojë ngjyrat kush lindi pa sy
më thuaj të lutem shumë më thuaj**

Mos na rëntë që ta harrojmë

(gjysëm milioni shqiptarë ikën nga Kosova në vitet 1980 dhe 1990)

**thonë se unë s'e zgjodha mërgimin
po se ai më zgjodhi mua**

unë protestoj:

**them që e kishim një relacion të ndërsjelltë
them se ishte aty diku një zgjedhje
mes jetës a vdekjes
e se vendimin e mora unë, dora vetë
më lëndon nëse e harron këtë**

***Andej kah kalëroje dikur
endet tash vetëm hija e besës sate
nuk shihet me sy s' preket me dorë
vetëm ndjehet
një ditë do të kthehesh, Konstandin***

imagjino Gjakovën:

**dhe i butë e kalldrëm
në trio uji
flladiten në hijen e Çabratit
xixëllonjat ndezin yjet**

Rastësi

Po të kish qenë im atë prind i mirë
për të na kursyer ne fëmijëve gjatë
darkës me gjizë e specë nga kuvendimet
lënduese mbi poshtërimet e përditshme të
jetës nën pushtim, e po të mos e kish
mbajtur Flamurin, atë Të mirin,
në arkën e fshehtë nën tokë; po të mos ma
kish treguar me dorë kodrën e Çabratit e matanë
majen e Shkëlzenit e mëtej një copë dhé, që
kundronte nën diktaturë - duke i ndarë me
sqimë autokracinë prej totalitarizmit plaku, sipas
definicioneve më taze të Franc Nojmanit -
e po të mos ma kish lëshuar ai Bik Ndojën e
Fitnete Rexhën, apo po ta kish fshehur Iliadën
nga rafti në vend se të ma linte nën jastëk, duke e
glorifikuar librin si ajër për mushkëritë
e si armë

Po të kish qenë ime ëmë prind i mirë
për të na kursyer ne fëmijëve gjatë
netëve të gjata pa baba nga lotët e nga ankthi prej
Skilës e Haribdës së papunësisë e frustrimeve të
jetës në Fabrikë, e po të mos ish frikësuar aq
dukshëm sa herë që shikonte Flamurin, atë Të mirin;
po të mos kish thënë nën zë Plaç! se na
more më qafë kur ia thirrja në lagje me këngë të
Bik Ndojës e Fitnete Rexhës në orët kur policia
i gjahtonte fëmijët për shkarje të prindërve e
anasjelltas; e po të mos i kishim shpejtuar hapat
kur e pamë Flamurin, atë Të mirin,
natën në qepenat e çarshisë para
komunës e mbi Xhaminë e Madhe e mbi Kishën e
Shën Ndout, e kur i pa të mbërthyera
si krishtin në muret e shkolles e si amanet i mbramë
dy fjalë me një pikëçuditëse

RRNOFTË SHQIPNIA!

(pikëçuditësja tmerrohej se ku e kishin vënë!)

**që mësuesi na bëri t'i lyenim me gëlqere
tërë ditën nën diell para se ta arrestonin - Atëherë
unë sigurisht që do të isha ndryshe:
nuk do t'i kisha lodhur kot me shqipen fëmijët, të cilët
s'do t'i kisha mbështjllur me Flamurin, atë Të mirin,
me të lindur; e s'do të kisha një arkë timen të
fshhtë**

**Si shtëpia si mendja ime do të kishin skaje të lëmuara
aty s'do të vriteshin qosheve
as shokët as dashnoret, po do të rrëshqisnin shlirë
si thiu në akull
buzagaz**

**se pajtohem në parim
më mirë thi i gjallë se thi kryefortë**

**e unë s'do të nunëroja më jare
O vjen një plak o andej paaaari**

**Rreth Gjakovës, mik, unë nuk shtoj.
Mundësisht heq.
Sepse jam në atë pozitën e çuditshme
të njeriut që e di se po ua tha vdektarëve
të vërtetën e plotë e të panaqetur
për natyrën përrallore të Gjakovës,
nuk do të besohej.
Më pëlqen kur has ca të frymëzuar,
që e parandjejnë atë të vërtetë.
Ma bën më të durueshme dijeninë.
E ua kam zili:
është mrekulli,
ai çasti i virgjër i zbulesës që e kanë përpara**

**qytet i djegur prej zotërash e djajsh
pre e pambrojtur e natës**

**rrafsh përtokë shtëpitë tua
e zërat e qeshjet e ëndërrat hirnosur**

**vrinë shkrumbi në hartë
ika tutje dhe e lashë veten këtu**

**në rruginat tua të ngushta te myshku në trungje
në mjegullat e përgjumura të parkut
e në dalldisjen e vapës, tek flen mbi hije selvish:
roje tradhëtare në zajet e Krenës**

**s'iku dot askush nga ti
as fantazmat me sytë kah Jugu
as të gjallët e bërë batër di**

**Thash t'i ngop mushkëritë prapë aromë bujashke
qytet i përcëlluar prej zotërash e djajsh
por as ajri s'qenka më njësoj tek ti**

(Gjakovë, 1999)

**unë vetëm zbatova urdhër
sikur edhe ti**

**nuk mbaj mend saktësisht
se ku e kur u rekrutova
ish kaherë, kam harruar tani
në më morën me dhunë a më joshën me lakmi
me premtime gjakderdhjesh lotësh a gjishë të bymyer
me kërcënim të vdekjes në vend
a me premtime për lavdi**

**në fund zbatova urdhër
ashtu si edhe ti**

ish kaherë, kam harruar tani

**kah vajtëm ku shkuan çfarë mbaruam
me zjarr e hekur mbi tokën e djegur
tejembanë tek premë e vramë me mëri e mizori
kam harruar o kam harruar tani**

**fundja unë vetëm zbatova urdhër
- armiku im i vjetër, këtë e kupton veç ti**

**tanimë as ku jam nuk e di
para portave të këtij Qyteti të humbur kam ngelur
me armën në dorë e me sy të përgjakur për lemeri
nuk e di
në më prunë këtej që ta vras e ta dhunoj këtë Njeri
e gruan e fëmijët e tij
- këta qen të pafe! –
a t'i mbroj
nga qentë e pafe
që duan ta vrasin ta dhunojnë këtë dhe**

**s'e di unë, as e di ti
ne veç urdhëra zbatojmë
armiku im i vjetër, e miku im i ri**

kundroj me habi
a është me mua a me ty ai
që turret këtej me armën e ngrehur
- vallë e ka ndërmend të më zhdukë mbi dhe,
të ma ngulë kokën në hu mbi çati
- ja ku më ke! qen i pafe! –
apo është shok i vjetër armësh
që është përmallë të toket përsëri
te kjo luftë e re, te ky varr i freskët, te kjo çmeri -

thuam
athua me kë është ky Njeri

tek mburret matanë me shqytin e lashtë kuqezi
tek qesh si engjëll me kam të përgjakur në dorë
tek falet për Jezu Muhamet e shën Mëri
hijerëndë, me Le Monde Diplomatique në këllëf

pashë Zotin që është Një
a e di kush vet a e di kë që e di

Më duhet më duhet një Urdhër
ta zbatoj përsëri
ashtu si kemi bërë tash e qëmoti

paj ne veç urdhëra zbatuam në histori
- Unë e Ti
armiq e doras të vjetër, miq e vëllamë të ri

(Prill 2002)

**në një gropore janë
përbri një rruge kryesore**

**askush s'e di
-vetëm unë e ti**

**përbri u kalojnë vetura
burra gra shtatzëna fëmijë
mbi ta përmjerrë përnatë roja e fabrikës**

**mbi eshtrat e tyre të nxirë
larg matanë Dhembjes e Harresës
gjëllin Jeta
pangurreshëm**

më vjen si vegim:

ja unë tek enden te bregu i lumit

**duke qepur
arna të diellit përmbi ujë**

**E shoh një gur. Është
i zi. Kërrusem për ta marrë.**

**Përballë më ulet galuc koha.
Më shikon. E shikoj. Më qesh.**

**Edhe ajo e vëren gurin.
I rriten bebëzat.**

**Me gisht pa ngjyrë shkruaj kuq:
JAM KËTU**

**largo hem pa e kthyer kokën, e
pas shpinës ndërron rrjedha**

kot e ka

**kam vënë
mballoma të dritës nën tokë**

1989

**A ju kujtohet ai vit i ligë, shoqëria ime?
Pyes a ju kujtohet, o njerëz!**

Mos na rëntë ta harrojmë!

**Amanet, më thoni që s'është harruar!
Që s'e ka mbuluar terri blu edhe atë vit.**

**duhet ta kesh provuar
zgjimin e beftë
nga një ëndërr e gjatë
kërcimin
në terrin e të panjohurës
thikën tek ashti shpirtin te fyti
pastaj ndoshta kuptohemi**

atje ku luajnë shtojzovallet,
ku perëndimi e lindja ngjajnë njëherit
e fletët nuk bijnë kurrë
prej pemësh të trallisura nga drita
që farfurinë si mbulojë, pëlhurë yjesh
nga veqet e qiellit drejt Dheut të Rëndë,
Therandës; atje ku engjëjt rrijnë të qeshur
ndër kepat e bardhë të Alpeve e rënët e Jonit
ndërsa njeridashja u ndrinë si sigël në ballë
ulur tek pushojnë te Dheu i Rëndë,
Theranda, e ku orë e zana e lumnojnë emrin tënd
me urata të moçme, në vargje e këngë;
atje ku endet harlisja e stinëve
para se ta shtrijë pëlhurën e vet mbi jetën:
atje, atje, e ke çelën ti e dashura ime,
qenia jote, lëkura jote e vetja jote e strukur nën të,
dhe s'ka njeriu si të mos tronditet:
kaq shumë vesë parajse rreth teje
e kaq e pambrojtur ti

**në një gropore janë
përbri një rruge kryesore**

**askush s'e di
-vetëm unë e ti**

**përbri u kalojnë vetura
burra gra shtatzëna fëmijë
mbi ta përmjerrë përnatë roja e fabrikës**

**mbi eshtrat e tyre të nxirë
larg matanë Dhembjes e Harresës
gjëllin Jeta
pangurreshëm**

Vëzhgim

**Ëndërra: mund ta ndërtosh jetën prej lëndës së tyre.
Njeriu: ai që ndërton jetë prej ëndërrash.**

Frustrim

**Ajo ndjenja që të krijohet kur e has gjysmën tënde.
Dhe nuk.**

**E shikoj në sy
e ndjej gjithë fuqinë e fjalës 'frustrim'
Kur e di, e ndjen diçka,
me tërë fuqinë dërmuese të besimit,
gjkimit, e përvojës:
me tërë unin tënd.
Por qindramijëra fjalët
e frazat e shqipes moderne
nuk e përshkruajnë dot.
Kur gjuha e lë poetin në baltë:
e ajo që duhej thënë kah del shpirti
të tall shkëlqimthi atje matanë.**

**Gjithçka, absolutisht çdo krim në këtë lug vajesh,
prej më të voglit gjer te më i tmerrshmi,
nis me një rrenë.**

Zakonisht rrenëz të vockël, të bardhë, e qëllimmirë.

**Mos më rrej më kurrë me qëllim të mirë.
Kurrë më!**

**E ti, si të dish vetë. Ja, unë zemrën time po ta jap prapë
në dorë.**

**Ja edhe syrin. Ja veshin. Ja tërë trupin: çdo gjymtyrë
që mund të të duhet.**

**Shkulma skeletin, krehe nga mishi, përdore për t'i varë
palët tua.**

Ç'ne dora jote, bosh? Ja, merre timen, ta kesh.

Bëj ç'të duash me to.

Bëj ç'të duash me mua.

Veç mos më rrej më me qëllim të mirë.

Kurrë më!

**Se nganjëherë nuk e shoh dashurinë tënde
e dua të besoj që është aty. Si dielli
në ditën e vrërët të dhjetorit.**

**Nuk shikohet dot, por e kupton njeriu
që ndodhet atje diku prapa reve, apo ajo.**

Më lër të të besoj, të lutem. Është me rëndësi.

**Nga të gjitha ndjenjat e species së njeriut,
afërsia qenka më e vështira për ta ndoruar.**

Por mos më rrej më me qëllim të mirë.

Kurrë më!

**Është punë qejfliu
ta kullos jetën nga poezitë**

**njerëzia shikojnë seri në ty:
së pari ia kafshon një thelë
të rrjedhë lëngu i metaforave nëpër cepa të buzëve
andje e ambël**

librari s'u beson syve të vet

**hisen që tepron e vë mbi tryezë
ta shijosh me nge
e vendosë çdo fjalë në pjata të vogla të arta**

**e ua përtyp ritmin
gjuhën rrjedhën atmosferën
dhembjen lozonjaren**

vizituesit të tjerë të shikojnë me bezdi

**thërrimet e derdhura në përdhesë i mbledh me dorë
i fut në qeska e botila të vogla si nuska të paçmueshme
(njerëzia do ta quanin këtë magji)**

**Është punë qejfliu kjo
ta kullos jetën nga poezitë**

**e ka njerëz që mbarojnë përditë urie
pse u mungon ajo që gjendet aty**

Përsëri

**për të satën herë
më ra ta shoh një vend magjeps
ku s'do të kthej më kurrë**

**një si pellg
(a qe sy toke?)
prehej mes blerimit të ertë
si macë e kotur**

**Që tani
më dhemb përbrenda si plagë:**

**e pashë kalimthi një vend të bukur
e s'do ta shoh kurrë më**

**Ka kohë që pyetesh
nëse jeton vërtet jetën tënde
apo të dashurive tua**

**end ëndërra
flutur e trallisur mes lulesh**

**athua mos e jeton shumën
e urrejtjeve tua**

**flutur flatragrisur
ke endur pëlhurën e fundit tënd**

Negacioni i dashurisë:

**më duaj me çdo kusht!
-sfido plagët që të kullojnë
dhembjen e çuar peshë
prej ndjenjave, mendimeve e sjelljeve të mia
ligësinë time manifeste
e të mirën time përherë latente
pa mbase, dikur,
do ta meritosh
të të dua edhe unë ty
ndryshe s'më ke dashur kurrë!**

**kur thanë se erdhi - kish vajtur
kur vajti - thanë se do të kthejë prapë dikur**

askush s'e mori vesh se ç'u bë

**ai Njeriu i panjohur me myshk e erëza
për ditëlindjen tënde të parë**

**më erdhi keq që s'e takova
e kisha pritur sa kohë
e kisha pritur tërë jetën time**

**dashnorja ime vie tek unë shlirë
futet brenda pa trokitur**

ajo e di që portat janë të hapura gjithnjë për të

**te dera e var kapotën e kësaj dite
i heq këpucët e lodhura dorashkat gri
nëpër këndet e lira i orendon
gëzimet zemërimet kuriozitetet e ditës**

**në ballkon i varë thjeshtësisht
arsyet e ekzistencës**

gjithçka që ka luajtur vend natën e kthen në vend sërish

**kur dashnorja ime është e trembur
kthen te unë si kafsha e pyllit te strofka e vet
për t'ia lëpirë plagët e veta**

**nganjëherë vie vet e dyta
e tërheq brenda zvarrë bishën e pikëllimit
ma lëshon të gjallë e të egër në dorë
t'ia zbus me ledhje përqafile duarsh fjalësh të ngrohta**

**s'e di o s'e di
s'e di se si ka besim kaq të madh në mua
andaj e dua**

**nga fytyra jote e dli­rë
-dëborë e papre­kur
vërshojnë
përrenj të trazuar
do t'u dal matanë edhe këtyre**

**Disa prej fotografive mund të zmadhohen.
T'i shikoj sytë. Më bëhet se vërej diçka.
Sikur pikas në to një vezullim të fshehtë.
Sikur prapa palëve tua të buta fshihet
një kokërr diamanti: e fortë: shkëlqyese: që je ti**

**Vërej që ke kaluar shumë shndërrime
Shumë kalime nga një epokë në tjetrën
Athua cili është aksi yt?
Stinët tua ç'ti rrotullon?**

**Kokrrën tënde dua ta josh nga strofka e vet.
E ta hukas. E ta ngroh në gojën time
në majat e mëndafshta të gishtërinjve të mi**

**Nuk mund të them se s'ta ndjej mungesën.
Shtëpia është përplot me ty.**

**Në banjo sapo ke bërë dush
përthanë flokët e ankohesh, i ke prerë shkurt
në kuzhinë e pi kafënë si çdo mëngjes**

**E lodhur kthehesh te dera
zbath këpucët me taka var pallton
heq palat e ditës një nga një**

**në shtrat
të prehet ende Gjumi më i thellë**

**Shtëpia është e mbushur me ty
dhe unë për vete s'them dot që s'ta ndjej mungesën**

**mbi barin e nxehtë shtriqet macja:
e shkrifëta, lozonjarja
pronë e askujt
ia ofron diellit konturat e veta
symbyllurazi
bën sikur flen, apo flen njëmend
s'besoj ta dijë as ajo vet
ashtu mes dy ëndërrash andet
krijesa kokete, përderisa ka rreze**

**në të perënduar, e zgjojnë instinktët e moçme
e lë një ëndërr për një tjetër, e i kthehet gjakftohtësisht
natyrës së vet vrasëse
jeton në të, pa u hamendur,
deri në agun e nxehtë të së nesërme**

**mbi barin e nxehtë shtriqesh ti
e shkrifët, lozonjare
pronë e askujt
në pritje të territorit të parë**

**mëngjes i acartë
ajri bymeget mbi ujin e gjelbër
breshka e re noton thellë
në brendinë e ngrohtë
mbi guralecët në fundin e errët
ndër blloqet ilirike, në qytetet e harruara
endet ndër statujat pa duar
e me sy lëmashku të gjelbër
gjithçka e mirë mund të ndodhë, gjithçka**

**mbi det bie dëborë
një cipë e hollë, e bardhë
valëvitet si pelerinë
-nën prehjen madhështore të palëve të saj
gjëllin e lazdohet
Jeta**

lozonjarja, e papërmbajtshmja

**tis i blertë i vesh anët e shpellës
errësirë e lagësht, e ngrohtë
strokë, gjallesë e strukur**

**Jeta end rrjetëza tejzash gjithandej
pafundësi fijesh, pafundësi mundësish
pëshpërijnë në pulsën e kësaj shpelle**

fli fëmijë e dashur, fli

**një kupë diell vere
nga vreshta jote
jep aromë në tryezë**

**rreth saj dhembja gëzimi
shpresa e larë
vënë në talure argjendi**

**përrjashta shtëpisë
pikla të një gjaku të hekurt
ndërtojnë stalaktite
e bolla e asfaltit e kafshon dheun
nën dëborë tinzare
përmbi të shfletohen me nge
faqet e Romanit të Madh**

**ç'ka ky qengj i zi që blegërinë
para portës sime**

**hëna e plotë e çon detin peshë
aty ku puqen elementet
kurorë madhështore stërpiklash**

natë e ndritshme tetori

**në thellësi:
prehje e moçme, e paprekur
nga tekat e hënës**

**Kush je ti o njeri? Që ma përkëdhel
trupin e mendjen me fjalë**

**Ka diçka premordiale, kanibale lale
në pasionet tua, "ta ha zemrën", më thua
"t'i ha sytë", "ta ha shpirtin"**

**lektisje egërshane nga lashtësi që s'përkthehen dot
e unë s'jam mësuar kështu
ndal vashëzo ndal ti ma ndal frymën**

Gjyshja sigurisht kish bërë petulla kur koha muar fund. Të shtunave kishte gjitmonë petulla për kaftjall. Agimet ishin të pafjalta në shtëpinë e gjyshërve të mi, ku heshtja vallëzonte mbi çati. Ishin pleq e me vitet edhe fjalët u kishin rënduar e i kishin flakur nga bordi, si barrë e panevojshme e zbuluar pas nisjes nga një kapedan i sertë. Ata s'kishin nevojë për fjalë për ta shquar ekzistencën e njëri-tjetrit.

Hëngrën sigurisht në kuzhinë. Përtypnin kafshata imcake e shikonin nga dritaret drejt kopshtit. Ishin të brengosur. Kopshti ngrinte ende pas një dimri të acartë. Toka ka nevojë për kohë, që të ngrohet e të japë. Pastaj u ulën sigurisht një çast të shkurtër, para se të dilte gjyshi për të prerë dru. Ai i kish thënë një herë gjyshes se rryma s'të ngrohte dot njësoj, e ajo s'kish patur zemër kurrë t'ia kthejë fjalën.

Qe mëngjes herak i një të shtune, qe ende acar e këmbana e ezanë paralajmëronin për një ditë të re kur unë ika. Për tre vjet rresht dualën aty në mëngjeset e së shtunës. Koha ish ulur këmbëkryq në kopshtin e pleqve e i shikonte ashtu siç e shikon edhe ata atë. Nganjëherë i buzëqeshnin njëri-tjetrit, pleqtë e koha, si të njohur të vjetër.

Kur gjithçka muar fund, kur pleqtë u lodhën e deshën ta kthejnë shpinën e të ikin, atëhere koha i puqi duart e veta. Ajo muar fund, e unë pendohem që s'isha aty me pleqtë atë të shtunën e mbramë para se të iknin.

**Mani ynë nxirrte fruta të bardha
që s'haheshin dot.**

**Kur na dyndën tërë qytetin
mani pa tek dilte tym i zi
nga shtëpitë e njerëzve që i njihte.**

**Qëkur u kthyem në shtëpi
pema nxjerr çdo verë fruta të zeza.
Të shijshme.**

**Nganjëherë më bëhet
se tërë lufta qe faji i tij.**

**Mbaje në mend shtëpinë tënde, biro. Ajo
ta dhuroi udhën e gjatë.
Diçka tjetër s'pati të të jipte.
Ta largosh të dashurin prej vetes është shpesh
kulmi i dashurisë.
Kur s'ke më tjetër për të dhënë.**

**E nëse kthehesh një ditë, e
shtëpia jote të duket e vogël, ta dish:
ajo s'të ka rrejt kurrë.
Kjo qe dhurata e saj. Aq kishte në dorë.
Këtë nder duhet t'ia mbash mend.**

***në një ëndërr gjithçka është e mundur
ke mendjen
jeta është një ëndërr***

SHQIPTAR OSEKU

P O E Z I

Korrektor / Redaktor

Shefki Oseku

Përpunimi kompjuterik

Frashër Oseku

U shtyp me ndihmën e ABF-it në Treleborg - Suedi

U dorëzua në shtyp në muajin prill të vitit 2013

Tirazhi 200 kopje

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG - SUEDI



SHQIPTAR OSEKU

U lind në Gjakovë më 19.10.70 Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në Gjakovë. Së bashku me familjen emigroi Suedi më 16. 04. 1989. Ka studjuar në Institutin për punë sociale, në Stokholm, Suedi. Tani punon si punëtor social në Stokholm. Është publicist dhe përkthyes nga gjuha shqipe në suedisht dhe gjuha suedeze në shqip.

KRYQESI I SHPIRTIT, është vepra e tij e parë, botuar më 2002.

P O E Z I është vepra e dytë, botuar më 2013.

Shqiptar Oseku është përkthyes edhe i tri veprave të tjera poetike, nga shqipja në suedisht dhe anasjelltas.

**LISTA E LIBRAVE TË BOTUARA NGA REVISTA "DRITA",
NË TRELEBORG - SUEDI.**

1. "Një lloj drite tjetër", poezi, shkruar nga Shefki Oseku, botuar në gjuhën shqipe më 1997, ribotuar disa herë me përmirësime të vogla. Libri është përkthyer në suedisht, gjermanisht, polonisht dhe anglisht.

2. "Hetimet", roman në gjuhën shqipe, autor Shefki Oseku, botuar në vitin 2000. Më vonë u ribotua disa herë me përmirësime të vogla.

3. "Kryqesi i shpirtit", poezi, shkruar nga Shqiptar Oseku, botuar në vitin 2000. Më vonë libri është ribotuar me përmirësime të vogla.

4. "Poezia shqipe suedisht dhe poezia suedeze shqip", botuar më 2001, përkthyer në të dy gjuhët nga Shqiptar Oseku. Libri u botua disa herë me përmirësime të vogëla.

5. "Ngjyrat e jetës", poezi, shkruar nga Esat Cërmjani, botuar më 2001.

6. "Arti shtetëror i letërsive të verbra", ese për letërsinë shqipe, shkruar nga Hazyr Dervishi, botuar më 2001.

7. "Kodi", roman në gjuhën shqipe, shkruar nga Hazyr Dervishi, botuar më 2004.

8. "Pocahontas Powhatan", roman në gjuhën shqipe, shkruar nga Hazyr Dervishi, botuar më 2008.

9. "Më shumë heroizma se sa grurë", tregim i letrarizuar që flet për shqiptarët, shkruar nga Ulmar Kvik. Libri u botua më 2004,

suedisht, kurse u përkthye nga Hajdin Abazi dhe u botua në shqip, më 2006.

10. "Historia e veshjeve popullore shqiptare - në shqip dhe suedisht", ku tregohen traditat e shqiptarëve që nga lindja e deri në vdekje. Libri u botua më 2006.

11. "Poetët nga Gjakova, në suedisht - Poetët nga Treleborgu, në shqip". Një libër me poezi në të dy gjuhët, shqip-suedisht, botuar më 2010. Libri u përkthye në të dy gjuhët nga Hajdin Abazi dhe Ulmar Kvik.

12. "Tre poetë shqiptarë, shqip-suedisht", ku janë përfshirë disa nga poezitë e Ismail Kadaresë, Frederik Reshpjes dhe Ali Podrimjes. Libri u përkthye nga Shqiptar Oseku dhe u botua më 2010.

13. "Ushtar i vonuar", roman në gjuhën shqipe, shkruar nga Shefki Oseku, botuar në vitin 2012.

14. "Poezia bashkëkohore shqipe në suedisht", ANTOLOGJI. Libri u botua në vitin 2013, përkthyer në suedisht prej Ulmar Kvikut, Hajdin Abazit dhe Shqiptar Osekut e ku janë përfshirë poetët më të njohur të poezisë bashkëkohore shqipe.

15. "Poezia bashkëkohore suedeze në shqip", ANTOLOGJI. Libri u botua në vitin 2013, përkthyer nga Shqiptar Oseku.

16. "Poezi", përmbledhje poetike, shkruar nga Shqiptar Oseku, botuar në vitin 2013

Shefki Oseku, Kryeredaktori i Revistës "Drita", në Treleborg, Suedi.

P.S.

Përveç këtyre librave, gjatë viteve 1996-2000, është botuar edhe gazeta e përmuajshme "Drita", në gjuhën shqipe dhe suedisht. Të 26 numrat e gazetës në fjalë u shpërndanë në shumë vende të botës. Një falënderim të veçantë për ABF-in në Treleborg, Suedi dhe posaçërisht për Arne Nilsonin dhe Lars-Olof Obergun. Po kështu e falënderoj edhe Nise Martinsonin, që në fillim na dha ndihmën e pakursyer. Një mirënjohje të veçantë për mikun e dëshmuar të shqiptarëve, Ulmar Kvikun. Falënderoj djalin tim, Frashërin, që me përkushtim punoi për nxjerrjen e gazetës "Drita". Ju jam mirënjohës edhe bashkëpunëtorëve të redaksisë së "Dritës", veçmas Ulmar Kvikut, Shqiptar Osekut, Hajdin Abazit dhe Zeqir Ramës.